



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA VLORE
KËSHILLI I BASHKISË

Nr. 8011 / prot.
11

Vlorë, më 05.10 2020

VENDIM

Nr. 76, Datë 01.10 2020

“PËR MIRATIMIN E PAGESËS SË STUDJOS” BAKER MCKENZIE” LIDHUR ME KUNDRAPADINË E BASHKISË VLORE DEPOZITUAR NË DHOMËN NDËRKOMBËTARE TË TREGËTISË PARIS, BAZUAR NË VKM NR.131, DATË 16.12.2018 PËR NGRITJEN E KUNDËRPADISË NË DHOMËN NDËRKOMBËTARE TË TREGËTISË, PARIS KUNDËR SHOQËRISË TIS-PARK”, LIDHUR ME KONTRATËN E KONCENSIONIT PARTNERITET PUBLIK/PRIVAT TË SISTEMIT DHE MENAXHIMIT TË PARKIMIT ME PAGESË NË QYTETIN E VLORES”

Bazuar në Ligjin nr.139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen Vendore”, neni 8, neni 9/1 pika 1/1 a dhe b, pika 1/3 c, nenet 34 dhe 54 pika dh, në Ligji, nr.68/2017 datë 27.04.2017 “Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore”, neni 45, Ligji nr.9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, neni 44, në Udhëzimin e Ministrisë së Financave nr.9 datë 20.03.2018 “Për Procedurat standart të zbatimit të buxhetit” si dhe Udhëzimit plotësues nr.1 datë 17.01.2019 “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2019”, në V.K.B-së Nr.92, dt.17.08.2018 “Për miratimin e përfaqësimit të Bashkisë Vlorë në Dhomën Ndërkombëtare të Tregëtisë, Paris”, në V.K.B nr.131 datë 06.12.2018 “Për ngritjen e kundërpadisë në Dhomën Ndërkombëtare të Tregëtisë, Paris kundër Shoqërisë Tis Park”, lidhur me kontratën e koncesionit partneritet publik/privat të sistemit dhe menaxhimit të parkimit me pagesë në qytetin e Vlorës, në VKB nr.114 datë 26.12.2019 “Për miratimin e buxhetit të Bashkisë Vlorë për vitin 2020” i ndryshuar në Vendimin e Gjykatës së Arbitrazhit, Paris datë 28.08.2020 si dhe në shkresën e Studjos “Baker MCKenzie” datë 10.09.2020, Këshilli i Bashkisë Vlorë

VENDOSI:

1. Të miratojë pagesën e Studjos “BAKER MCKENZIE “për depozitim të kërkesëpadisë së Bashkisë Vlorë ndaj Shoqërisë Tis Park në Dhomën Ndërkombëtare të Tregëtisë lidhur me kontratën e Koncesionit në shumën 208000 USD e llogaritur si Tarifë Suksesi.
2. Njohja e detyrimit sipas pikës 1 bëhet me kusht që pagesa e shumës bazuar në Tarifën e Suksesit të miratuar me VKB nr.131, datë 06.12.2018 “ Për ngritjen e kundërpadisë në Dhomën Ndërkombëtare të Tregëtisë, Paris kundër Shoqërisë Tis-Park”, lidhur me kontratën e koncesionit partneritet publik/privat të sistemit dhe menaxhimit të parkimit me pagesë në qytetin e Vlorës”, të bëhet nga shumat që me vendim të Dhomës Ndërkombëtare të Tregëtisë, Shoqëria “Tis Park” i detyrohet Bashkisë Vlorë ose nga

Shoqëria "Tis Park" i detyrohet Bashkisë Vlorë ose nga tepricat e pagesës vsë kryer nga Bashkia Vlorë pas llogaritjes për kostot e procedurës së Arbitrazhit.

3. Referuar Pikës 2 të Autorizohet Studjo Baker Mckenzie të kryej procedurat përkatëse ligjore për të mundësuar arkëtimin e vlerës financiare të diferencës midis pagesës dhe kostove të Arbitrazhit si dhe vlerën e kundërpadinë si detyrime të Shoqëria Tis Park ndaj Bashkisë Vlorë.
4. Për zbatimin e këtij Vendimi ngarkohet Kryetari dhe Administrata e Bashkisë Vlorë.
5. Ky vendim hyn në fuqi sipas ligjit Nr.139, datë 17.12.2015 "Për vetëqeverisjen Vendore". neni 55 pika 6.

Konceptoi: *D.Zeraj*

